



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

KORNIZA E POLITIKAVE PËR ZHVENDOSJE

E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
PËR ZONËN FUSHA E MIHJES SË RE

SHKURTESAT

FZhK	Fondi për Zhvillimin e Komunitetit (OJQ lokale)
EUR	Euro
IFC	Korporata Financiare Ndërkombëtare (Banka Botërore)
IFC PS-5	Standardi i Performansës 5 i IFC-së (Përvetësimi i tokës dhe zhvendosja jovullnetare)
AKK	Agjencia Kadastrale e Kosovës
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
AKP	Agjencia Kosovare e Pronave
PATEL	Projekti i Asistencës Teknike për Energji nga Linjiti
M&V	Monitorimi dhe Vlerësimi
MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
PVZh	Plani i Veprimit për Zhvendosje
KPZh	Korniza e Politikave për Zhvendosje
VSMS	Vlerësimi Strategjik Mjedisor dhe Social
WB OP 4.12	Politika Operative e Bankës Botërore 4.12 (Zhvendosja jovullnetare)

PËRMBAJTJA

HYRJE.....	4
PARIMET DHE OBJEKTIVAT.....	5
PËRGJEGJËSITË INSTITUCIONALE.....	6
PRANUESHMËRIA DHE AUTORIZIMET.....	9
OPSIONET E ZHVENDOSJES.....	9
OPSIONET E ZHVENDOSJES NË PROJEKTIN ENERGJIA NGA LINJITI.....	13
NJERËZIT E PREKUR NGA HUMBJA E TOKËS (TOKA BUJQËSORE, KULLOSA, TOKA PYJORE).....	13
PERSONAT E PREKUR NGA HUMBJA E VENDBANIMIT.....	16
PERSONAT E PREKUR NGA HUMBJA E VEPRIMTARISË AFARISTE APO LOKALEVE KOMERCIALE.....	16
PERSONAT E PREKUR NGA HUMBJA E PUNËSIMIT.....	17
SHPENZIMET KALIMTARE.....	17
KRITERET PËR KUALIFIKIM.....	18
DATAT E NDËRPRERJES.....	18
EKONOMIA FAMILJARE.....	18
REALIZUESHMËRIA E ZONAVE TË MBETURA NË IMPLEMENTIMIN E PROJEKTIT ENERGJIA NGA LINJITI.....	18
PËRCAKTIMI I VLERËS SË ASETEVE.....	19
PARIMET E PËRCAKTIMIT TË VLERËS.....	19
PROCEDURAT SPECIALE PËR PROJEKTIN ENERGJIA NGA LINJITI.....	19
KONSULTIMI PUBLIK.....	21
PROCEDURAT SPECIALE PËR PROJEKTIN ENERGJIA NGA LINJITI PËR KONSULTIME PUBLIKE.....	21
PLANI KOHOR DHE BUXHETI.....	22
PLANI I INTEGRUAR KOHOR DHE BUXHETI.....	22
ORARI KOHOR DHE BUXHETI PËRAFËRT.....	22
SHTOJCA A: MODELI I PLANIT TË VEPRIMIT PËR ZHVENDOSJE.....	23
1. HYRJE.....	23
2. STUDIME DHE DEFINICIONE TË BAZËS SOCIO-EKONOMIKE.....	23
3. KORNIZA LIGJORE DHE INSTITUCIONALE.....	24
4. KOMPENSIMI DHE REHABILITIMI.....	25
5. TRANSPORTI DHE ÇËSHTJET TJERA KALIMTARE.....	26
7. KONSULTIMET PUBLIKE DHE PROCEDURAT E ANKIMIT.....	26
8. ORARI DHE PËRGJEGJËSITË PËR ZBATIMIN E PLANIT TË ZHVENDOSJES.....	27
9. SHPENZIMET.....	27
10. MONITORIMI DHE VLERËSIMI (M&V).....	27

Hyrje

Korniza e politikave për zhvendosje (KPZh) për zonën Fusha e Mihjes së Re e përcaktuar me vendimin e Qeverisë nr. 02/57 të datës 13.03.2009, përkufizon politikat e Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me zhvendosjen e popullatës që do të duhet të rilokohet për shkak të zhvillimit të aktiviteteve të rëndësishme infrastrukturore dhe minerare, për të cilat është i domosdoshëm përvetësimi i pronave të paluajtshme. Kjo KPZh synon t'i zbatojë të gjitha aspektet e projektit të mihjes së linjtit dhe prodhimit të energjisë elektrike të njohur si Projekti i energjisë nga linjiti, përfshirë zhvendosjen që duhet kryer për përvetësim të tokës për operacione minerare apo stabilimente ndihmëse.

Në këtë dokument shtjellohen edhe detajet specifike të kësaj KPZh-je të cilat aplikohen në Projektin e energjisë nga linjiti. Kompania e Projektit që do të udhëheqë Projektin e energjisë nga linjiti do të ketë të drejtë të kërkojë nga organi shpronësues i Qeverisë aprovim të zhvendosjes, gjë që do të kushtëzohet me sajimin e Planeve të veprimit për zhvendosje (PVZh-ve) sipas kësaj Kornize të politikave për zhvendosje. Korniza e politikave për zhvendosje ka për qëllim që të udhëzojë sajimin e PVZh-ve të para për Projektin e energjisë nga linjiti si dhe PVZh-ve të mëtejme që sajohen në ndërlidhje me këtë projekt.

Mes çështjeve kryesore të adresuara nga ky dokument janë:

- Përkufizimi i palëve përgjegjëse për hartimin dhe miratimin e PVZh-ve definitive për projekte, zhvillimi i të cilëve kushtëzohet me zhvendosje të popullatës. PVZh-ja e parë duhet t'i përmbajë të gjitha definicionet, kriteret e pranueshmërisë, përfitimet dhe procedurat që do aplikohen gjatë tërë projektit. Nëse një projekt ndërthen përvetësime të shumta me kalimin e kohës, mund të jetë e rrugës që të përgatiten PVZh të ndara për secilën fazë të përvetësimit. Për shembull, në Projektin e energjisë nga linjiti miniera do të zgjerohet në një periudhë që mbulon shumë vite. Megjithatë, kriteret, përfitimet dhe procedurat do duhej të jenë të njëjta në të gjitha PVZh-të.
- Definimi i përgjegjësive institucionale për financimin dhe implementimin e PVZh-së.
- Fushëveprimi i PVZh-së.

Parimet dhe objektivat

Siç thuhet në këtë KPZh, objektive primare e Qeverisë është të minimizojë përvetësimin e tokave dhe zhvendosjen gjatë zhvillimit të infrastrukturës dhe veprimtarisë së domosdoshme. Këto objektiva janë konsistente me standardet ndërkombëtare, në veçanti me Politikën operationale OP 4.12 të Bankës Botërore dhe Standardit të Performansës 5 të Korporatës Financiare në Ndërkombëtare (IFC). Në rastet kur janë të pashmangshme zhvendosja apo humbja e asetëve ekonomike dhe mjeteve të mbijetesës, objektive e këtyre politikave është të sigurohet se njerëzit e prekur do të mund të përmirësojnë apo së paku ta mbajnë standardin e tyre të jetesës dhe jetët e tyre, në kohën më të shkurtër të mundshme.

Kjo KPZh merr parasysh ndikimet e theksuara sociale dhe ekonomike të përvetësimit të tokave dhe zhvendosjes. Mes ndikimeve kryesore sociale dhe ekonomike të përvetësimit të tokave janë edhe:

- Humbja e tokave. Në rastet kur një pjesë e tokës bujqësore, apo e tërë toka bujqësore e një personi humbet, këta të fundit do të humbin të ardhurat e shpesh edhe një pjesë të rëndësishme të furnizimeve të ushqimit të tyre (si për shembull, perimet, qumështin dhe shpezët). Në proces të zhvendosjes në lokacionin e ri ata ka shumë të ngjarë të humbin së paku një të korrur.
- Humbja e vendbanimit. Krahas humbjes së strukturës fizike të shtëpisë, njerëzit gjithashtu i humbin shërbimet dhe stabilimentet përcjellëse, siç janë furnizimi me ujë, kanalizim, qasje rrugore dhe energji elektrike. Gjithashtu, gjatë procesit të zhvendosjes do të përballen me shpenzime të caktuara tranzitore, përfshirë këtu edhe shpenzimet e transportit për ata dhe për gjësendet e tyre personale, ngarkesat juridike, tatimet, etj.
- Humbja e biznesit. Krahas humbjes së premisave fizike, bizneset e vogla mund të preken nga humbja e lokacioneve të caktuara dhe humbja e klientelës, në veçanti nga humbja e konsumatorëve të tyre të rregullt. Gjatë procesit të zhvendosjes, ata do të pësojnë humbje dhe mund të përballen me shpenzime të caktuara tranzitore, siç është transporti i pajisjeve, mallit, etj.
- Humbja e vendit të punës. Nëse një biznes i prekur mbyllet, atëherë punëtorët do të humbin vendet e tyre të punës. Disa të tjerë mund ta humbin vendin e punës për shkak se janë të detyruar që të udhëtojnë gjatë nga vendbanimet e tyre të reja.
- Humbja e shërbimeve dhe trashëgimisë kulturore. Këtu përfshihen humbja e qasjes ndaj stabilimenteve siç janë shkollat, klinikat, xhamitë, varret, përmendoret përkujtimore të luftës apo stabilimentet tjera.

Përgjegjësitë institucionale

Kur Kompanitë e Projektit janë të përfshira në zhvillimin e aktiviteteve të mëdha infrastrukturore për të cilat është e domosdoshme të bëhet përvetësimi i tokave dhe zhvendosja, përgjegjësitë e kompanisë së projektit, Qeverisë dhe Komunave duhet të jenë të qarta. Për të siguruar se personat e zhvendosur mund të përmirësojnë apo të mbajnë standardin e tyre të jetesës, përgjegjësitë për përvetësimin e tokave dhe zhvendosjen duhet të ndahen mes kompanisë së projektit, Qeverisë dhe Komunave si në vijim:

Përgatitja e Planeve të Veprimit për Zhvendosje (PVZh). Kompania e projektit do të jetë përgjegjëse për përgatitjen e PVZh-ve. Këto PVZh duhet të bazohen në Vlerësimin Strategjik Mjedisor dhe Social (VSMS), në hulumtimet e kryera nga Prism dhe Fondi Zhvillimor i Komunitetit (CDF), në këtë KPZh dhe në studimet apo propozimet tjera që janë kryer nga Projekti i Asistencës Teknike për Energji nga Linjiti (PATEL), Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE) apo Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. PVZh duhet përgatitur për çdo projekt që ka si rrjedhojë shpronësimin e tokës, zhvendosjen fizike të popullatës apo humbjen e biznesit ose ndryshimin e destinacionit të tokave apo qasjes ndaj resurseve. Të gjitha PVZh-të duhet t'i nënshtrohen konsultimeve publike. Të gjitha PVZh-të duhet t'i përmbahen standardeve të pranura ndërkombëtare, siç është OP 4.12 i Bankës Botërore dhe PS-5 i IFC/Grupi i Ekuatorit. Planet e zhvendosjes duhet të bazohen në informata të azhurnuara dhe të besueshme dhe duhet të përfshijnë informata bazike mbi projektet përkatëse si dhe një analizë të opsioneve alternative për projektet e propozuara apo analizës të opsioneve alternative të projektit të propozuar, si dhe të gjitha çështjet juridike që ndërlidhen me zhvendosjen apo mospajtimet mes ligjeve të Kosovës dhe standardeve ndërkombëtare. Krejt në fund, të gjitha PVZh-të duhet të përfshijnë një buxhet dhe orar të detajuar. Në aneksin A është paraqitur një skicë e një PVZh-je të tillë:

- Miratimi i PVZh-ve. Organi shpronësues (autoriteti brenda MESP, i cili ka përgjegjësinë për shpronësim sipas vendimit të Qeverisë së Kosovës me Nr. 05/147 dhe datë 05.10.2010) do të jetë përgjegjës për miratimin e PVZh-ve dhe do duhej që gjatë këtij procesi të merr komentet nga palët e përfshira dhe komunitatet e prekura. Marrëveshjet e arritura për vlersimin dhe kompensimin e pasurisë me familjet e prekura mund të marrin formën e një kontrate civile apo një marrëveshjeje formale mes Kompanisë së projektit dhe përfaqësuesve të familjeve të prekura.
- Caktimi i vlerës. Kompania e Projektit do të bëjë vlerësimin e pasurisë si dhe caktimin e shumës së kompensimit, në mënyrë që të sigurohet se çmimet e vlerësimeve të jenë sipas çmimeve të tregut dhe të vlerës së ndërrimit.
- Pronarët e zhvendosur nga lufta e fundit. Agjencia Kosovare e Pronave (AKP) është përgjegjëse për identifikimin apo kontaktimin e të gjithë pronarëve të

pronave që janë larguar gjatë luftës. Mandati i AKP-së është i kufizuar në funksionin aktual të tij të caktimit të pronësisë mbi asetet. Kompania e projektit do të jetë përgjegjëse për negocimin me pronarët e pronave të prekura. Opsionet e ofruar për pronarët e pronave të prekura që janë zhvendosur si rezultat i luftës do të jenë të njëjta me ato të ofruara për pronarët tjerë të prekur.

- Implementimi dhe Monitorimi i Planeve të veprimit për zhvendosje (PVZh). Kompania e projektit do të jetë përgjegjëse për të kompensuar me para të gatshme, opsionin tokë-për-tokë, ndërtimin e lokacioneve të reja për zhvendosje apo me pronë tjetër të paluajtshme që ka vlerë të barabartë me pronën e kompensuar; apo me një kombinim të parave të gatshme dhe pronës së paluajtshme, kombinim ky i cili duhet të ketë vlerë të barabartë me pronën që kompensohet dhe/apo për t'i paguar kompensimin familjeve të prekura. Organi Shpronësues është përgjegjëse për monitorim e implementim të PVZh-ve nga kompania e projektit.
- Komisioni i pavarur për shqyrtim të ankesave. Komisioni i pavarur për ankesa duhet të themelohet për të mbuluar të gjitha aspektet e projektit. Ky komision do të përbëhet prej: Kompanisë së Projektit, Komuna, Organi Shpronësues, Komuniteti dhe MMPS. Nëse pronari apo bartësi i interesave në pronën e paluajtshme që është subjekt i zhvendosjes beson me arsye se të drejtat e tij janë shkelur, atëherë ai person mund të parashtrojë një ankesë përkatëse pranë këtij komisioni. Mënyra e funksionimit të këtij komisioni do të përcaktohet në secilën PVZh. Vendimi i komisionit të pavarur për shqyrtim të ankesave do të jetë përfundimtar dhe në rast se pala është e pa kënaqur nga ky vendim, atëherë vlerësimi për atë pronë të paluajtshme nuk do të jetë subjekt i zhvendosjes sipas kësaj kornize dhe do të fillojë procedura e shpronësimit në përputhje me procedurat dhe afatet e parapara ligjore sipas ligjit për shpronësim të pronës së paluajtshme.

Kompania e Projektit inkorporon procedurën e komisionit të pavarur për shqyrtim të ankesave të cilën e paraqet në mënyrë detaje në PVZh. Kjo procedurë e komisionit mbulon të gjitha aspektet e projektit, jo vetëm programin e zhvendosjes. Komisioni i Pavarur për shqyrtim të ankesave me përbërjen e saj të përcaktuar më lartë mbështetet nga një ekspert teknik i cili ka qasje të drejtpërdrejtë në nivelet më të larta të menaxhimit të Kompanisë së Projektit, autoriteteve lokale dhe qeverisë qendrore. Ky komision financohet nga Kompania e Projektit, mirëpo i jep llogari drejtpërsëdrejti Kabinetit të Ministrit të Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Agjencive Ndërkombëtare Financiare të përfshira në financimin e projektit. Eksperti teknik do të ketë zyrë në zonën e projektit dhe mjet transportues për të bërë vizita dhe inspektime kudo në zonën e projektit. Telefoni, posta elektronike dhe lokacioni i zyrës së ekspertit teknik do të reklamohen gjerësisht para opinionit publik. Të gjitha ankesat shqetësimet regjistrohen në një bazë konfidenciale të të dhënave. Komisioni kërkohet që të

hetojë dhe t'i përgjigjet çdo ankese apo shqetësimi brenda një periudhe prej jo më shumë se 30 ditë. Eksperti teknik do të përgatitë edhe raporte tremujore, duke treguar numrin e ankesave, identifikuar problemet e ngritura dhe masat që janë ndërmarrë për t'i zgjidhur problemet e paraqitura. Emrat dhe informatat e kontaktimit të ankuesve (adresa, numri i telefonit, adresa e postës elektronike, etj.) mbesin konfidenciale; ato regjistrohen në bazën e të dhënave por nuk shpalosen në raportet e rregullta të punës.

Pranueshmëria dhe autorizimet

Opsionet e zhvendosjes

Në matricën e pranueshmërisë, të paraqitur në Tabelën 1, ofrohen të përmbledhura opsionet të cilat do t'i ofrohen kategorive të ndryshme të personave që preken nga projektet. Opsionet e zhvendosjes, nga konteksti i Projektit të energjisë nga linjiti, janë përshkruar më detajisht në Tabelën 1 në vijim.

Tabela 1: Matrica e pranueshmërisë – opsionet e zhvendosjes

Personat e prekur	Opsionet	Vështrime
Personat e prekur nga humbja e tokës bujqësore		
<p>Pronarët me të drejta të plota, ngastrat e të cilëve do të preken tërësisht</p> <p>(persona shtëpitë e të cilëve janë prekur gjithashtu kanë të drejtë t'i shfrytëzojnë opsionet e dhëna më poshtë)</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Një ngastër tjetër në tokë të rehabilituar + kompensim për asetet tjera (ahur, ndërtesa ndihmëse, rendiment të përhershëm, etj.), ose • Në mungesë të tokës së rehabilituar bëhet kompensim në para të gatshme për tokën dhe asetet tjera <p>+ të gjitha shpenzimet tranzitore (transporti, ngarkesat juridike, humbja e rendimenteve apo fitimeve)</p>	<p>Ngastra alternative apo kompensimi me para të gatshme paraqesin opsionin e preferuar për personat që varen nga bujqësia. Kompensimi duhet të jetë i mjaftueshëm për t'i mundësuar përfituesit që të përvetësojë një ngastër më të mirë apo së paku të cilësisë së barabartë me ngastrën e prekur.</p>
<p>Pronarët e identifikuar që nuk kanë pronësi të plotë mbi tokën dhe ngastrat e të cilëve do të preken tërësisht</p> <p>(persona shtëpitë e të cilëve janë prekur gjithashtu kanë të drejtë t'i shfrytëzojnë opsionet e dhëna më poshtë)</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Një ngastër tjetër në tokë të rehabilituar + kompensim për asetet tjera (ahur, ndërtesa ndihmëse, rendiment të përhershëm, etj.), ose • Kompensim në para të gatshme për tokën dhe asetet tjera <p>+ të gjitha shpenzimet tranzitore (transporti, ngarkesat juridike, humbja e rendimenteve apo fitimeve)</p>	<p>Në mungesë të pronësisë së plotë, pronari/pronarët duhet të identifikohen si persona me të drejta të plota të pasfiduara mbi pronën. Kjo kërkon vërtetim të të drejtave pronësore dhe një deklaratë të depozituar nga fqinjët që do të vërtetohet nga komuna.</p>

Personat e prekur	Opsionet	Vështrime
Pronarët e tokave që janë larguar nga zona si rrjedhojë e luftës së fundit në Kosovë, dhe pronat e të cilëve preken tërësisht	<ul style="list-style-type: none"> • Një ngastër tjetër në tokë të rehabilituar + kompensim për asetet tjera (ahur, ndërtesa ndihmëse, rendiment të përhershëm, etj.), ose • Në mungesë të tokës së rehabilituar bëhet kompensim në para të gatshme për tokën dhe asetet tjera + të gjitha shpenzimet tranzitore (transporti, ngarkesat juridike, humbja e rendimenteve dhe/ose fitimeve) 	Është e kuptueshme se shumica e atyre që janë larguar do të kërkojnë kompensim me para të gatshme. AKP do të jetë përgjegjëse për të vendosur se kush do të ketë të drejtë të përfitojë nga kjo.
Pronarët e tokave pronat e të cilëve preken pjesërisht (p.sh. ku pjesë tjera mbeten të përdorshme)	<ul style="list-style-type: none"> • Kompensimi për humbje të tokave bujqësore dhe asetëve tjera të prekura (ahur, ndërtesa ndihmëse, rendimente, etj.) 	Ligji në fuqi definon rastet e shpronësimit të pjesshëm.
Bujqit me qira apo gjysmëtarë	<ul style="list-style-type: none"> • Kompensimi për humbjen e fitimit neto për dy vite + të gjitha shpenzimet tranzitore (transport dhe ngarkesa juridike) 	Të sigurohet se qiramarrësit të jenë në gjendje të marrin përsipër kontrata të reja qiraje.
Jopronarët që kanë okupuar prona që u përkasin personave që janë larguar gjatë luftës së fundit në Kosovë	<ul style="list-style-type: none"> • Kompensimi me para të gatshme për vlerën e përmirësimeve të bëra dhe për rendimentin aktual. 	Nuk kanë të drejtë në përfitime të zhvendosjes.
Personat e prekur nga humbja e shtëpive dhe toka ndërtimore		
Pronarët e identifikuar me pronësi formale mbi shtëpitë e tyre	<ul style="list-style-type: none"> • Një shtëpi e re dhe një parcelë për ndërtim në fshatin e zhvendosjes, 	Vendbanimi zëvendësues do t'i plotësojë standardet bazike të banimit shoqëror

Personat e prekur	Opsionet	Vështrime
(krahas komensimit të tokës bujqësore)	<p>apo</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kompensim bazuar në shpenzimet e zëvendësimit <p>+ të gjitha shpenzimet tranzitore (ngarkesat juridike, taksat, transporti i gjësendeve personale, etj.)</p>	<p>dhe do të ofrojë shërbime përkatëse, pa marrë parasysh gjendjen apo vlerën e pronës së prekur, nëse një objekt joligjor është ndërtuar në pronë private nga pronari i saj, dhe a) në datën e fillimit të veprimtarisë ndërtuese pronari e ka pasur të pamundur të marrë lejen nga autoritetet komunale për shkak se, deri në atë datë, nuk ka ekzistuar një plan urban apo hapësinor për pronën në fjalë; dhe b) as ndërtesa as ndërtimi i saj nuk janë bërë duke shkelur ligjet apo rregulloret e zbatueshme në atë kohë.</p> <p>Në mungesë të pronësisë së plotë juridike, pronari duhet të identifikohet si person me të drejta të plota dhe të pasfiduara mbi pronën. Kjo kërkon vërtetim të të drejtave pronësore dhe një deklaratë të depozituar nga fqinjët që do të vërtetohet nga komuna.</p>
Pronarët e shtëpive që janë larguar si rrjedhojë e luftës së fundit në Kosovë	<ul style="list-style-type: none"> • Një shtëpi e re dhe një parcelë për ndërtim në fshatin e zhvendosjes, apo • Kompensim bazuar në shpenzimet e zëvendësimit <p>+ të gjitha shpenzimet tranzitore (ngarkesat juridike, taksat, transporti i gjësendeve personale, etj.)</p>	Nënkuptohe se shumica e personave që janë larguar do të kërkojnë kompensim me para të gatshme. AKP do të jetë përgjegjëse për vërtetim të pronësisë.
Qiramarrësit me marrëveshje formale të qirasë	<ul style="list-style-type: none"> • Kompensim ekuivalent me qiranë gjashtëmujore 	Qiramarrësi do të kompensohet për dëmet që

Personat e prekur	Opsionet	Vështrime
	+të gjitha shpenzimet tranzitore (ngarkesat juridike dhe taksat, transporti, etj.)	janë krijuar si rrjedhojë e shkëputjes së kontratës. Duhet të përcaktohet nëse mund të përgatiten marrëveshje të reja qiraje. Përfituesit duhet të kenë marrëveshje formale që daton para datës së pranueshme.
Banuesit jopronarë, përfshirë uzurpuesit e shtëpive të braktisura nga popullata gjatë luftës (banorët e paligjshëm).	<ul style="list-style-type: none"> • Një shumë tranzitore për t'i lëvizur plaçkat • Kompensim për tre muaj qira për një hapësirë të ngjashme gjetiu. 	
Personat e prekur nga humbja e biznesit dhe ndërmarrjet tjera		
Pronarët e lokaleve afariste, siç janë shitoret, punëtoritë apo garazhat	<ul style="list-style-type: none"> • Zëvendësimi i lokaleve me lokale në fshatin e zhvendosjes, apo • Kompensim për humbje të lokaleve <p>+ kompensim për humbje të të ardhurave neto gjashtë mujore apo të ardhurave neto dymbëdhjetë mujore nëse përfituesi rihap një biznes në komunë</p> <p>+ të gjitha shpenzimet tranzitore, përfshirë paketimin dhe bartjen e pajisjeve, ngarkesave juridike, tatimeve, etj.</p>	Norma të ndryshme kompensimi ofrohen për të inkurajuar pronarin që të rihapë biznesin apo të hapë një biznes të ri në komunën e prekur.
Jopronarët	<ul style="list-style-type: none"> • + kompensim për humbje të të ardhurave neto gjashtë mujore apo të ardhurave neto dymbëdhjetë mujore nëse përfituesi rihap një biznes në komunë <p>+ të gjitha shpenzimet tranzitore, përfshirë paketimin dhe bartjen e</p>	Norma të ndryshme kompensimi ofrohen për të inkurajuar pronarin që të rihapë biznesin apo të hapë një biznes të ri në komunën e prekur.

Personat e prekur	Opsionet	Vështrime
	pajisjeve, ngarkesave juridike, tatimeve, etj.	
Qeveria, komunat dhe ndërmarrjet publike (për asete si ndërtesat shkollore, klinikat, ujësjellësit, linjat e shpërndarjes së energjisë elektrike, etj.)	<ul style="list-style-type: none"> • Kompensimi i aseteve, në bazë të shpenzimeve për zëvendësim, apo • Zëvendësim i aseteve në lokacionin e ri të zhvendosjes 	Ujdia të arrihet për secilin rast ndaras.
Asetet e komunitetit, në veçanti xhamitë, varrezat dhe kishat	<ul style="list-style-type: none"> • Rilokimi dhe restaurimi, apo zëvendësimi 	Në pajtim me komunitetet për secilin rast ndaras.
Personat e prekur nga humbja e vendeve të punës		
Punëtorët me vend të plotë pune që humbin vendet e punës për shkak të shpronësimit të lokaleve të punëdhënësve	<ul style="list-style-type: none"> • Kompensimi ekuivalent me pagën gjashtëmujore • Përkrahje financiare (1,000 euro) për të mbuluar shpenzimet e trajnimeve apo kërkimit të punës. 	Kompensimi do të bazohet në të ardhurat mesatare të tyre gjatë 12 muajve të fundit. Për gjetje të vendeve alternative të punës do të ofrohet ndihmë.
Personat që humbin vendet e punës me gjysmë orari	<ul style="list-style-type: none"> • Kompensimi ekuivalent me të ardhurat gjashtëmujore për punë me gjysmë orari, plus përkrahja për të gjetur punësim apo mundësi trajnimi 	Kompensimi do të bazohet në të ardhurat mesatare të tyre gjatë 12 muajve të fundit. Për gjetje të vendeve alternative të punës do të ofrohet ndihmë.

Opsionet e zhvendosjes në Projektin Energjia nga Linjiti

Në kontekst të Projektit Energjia nga Linjiti, do të ofrohen opsionet vijuese të zhvendosjes për kategori të ndryshme të personave të prekura nga projekti:

Njerëzit e prekur nga humbja e tokës (toka bujqësore, kulloso, toka pyjore)

Pronarët e tokës: Personave, toka e të cilëve është prekur nga projektet e mihjes apo të energjisë, do t'u ofrohet ose një parcelë alternative në një tokë të rehabilituar nga fusha e madhe e deponisë

së djerrinës që aktualisht i përket Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK) (“tokë për tokë”), apo kompensim në para të gatshme të mjaftueshëm për blerjen e një parcele të një hapësire dhe cilësie ekuivalente me parcelën e prekur, nëse toka e rehabilituar nuk është në dispozicion. Të gjitha shpenzimet e bartjes do të mbulohen drejtpërsëdrejti nga kompania e projektit apo do të kompensohen. Këto shpenzime përfshijnë shpenzimet e transportimit të pajisjeve, makinerisë, bagëtisë dhe të gjitha mjeteve tjera të lëvizshme, të gjitha tarifatat ligjore dhe taksat e nevojshme për transferimin e tokës së tyre dhe blerjes apo zëvendësimit të parcelave, si dhe kompensimin për çdo humbje të të korrurave apo humbjeve tjera të të ardhurave dhe/apo mjeteve të jetesës.

Të tri opsionet do t’u ofrohen të gjithë pronarëve të tokës të cilët janë tërësisht të prekur, e që varen tërësisht apo për një pjesë të konsiderueshme për jetesë nga prona e prekur, dhe të cilët nuk kanë në pronësi apo në zotërim zotërimi tjera të zbatueshme. Pronarët e tokës që nuk varen në jetesë nga toka e tyre: d.m.th. toka e të cilëve është prekur pjesërisht, të cilët e lëshojnë me qira tokën e tyre në qiramarrje formale apo në marrëveshje të gjysmatarëve apo të cilët kanë zotërimi të tjera të zbatueshme, kualifikohen vetëm për kompensim. Kriteret për përkufizim se cilat prona klasifikohen si tërësisht të prekura dhe cilat si pjesërisht të prekura janë paraqitur në ”Realizueshmëria e zonave të mbetura në implementimin e Projektit Energjia nga Linjiti” më poshtë. Këto opsione do të ofrohen pavarësisht nëse pronarët e tokës banojnë apo jo në parcelën e prekur (të drejtat për personat shtëpitë e të cilëve janë prekur janë paraqitur më poshtë në mënyrë të veçantë). Opsionet do t’u ofrohen të gjithë personave që kanë fletëposedim ligjor për tokën apo të cilët pranohen se kanë të drejta të plota, të pasfidueshëm të pronësisë. Për sa i përket të drejtave të parregullta, duhet të theksohen pikat në vijim:

- Toka që fillimisht është blerë përmes transferimit joligjor (siç është kontrata e paregjistruar civile) duhet ta kenë të rregulluar atë nga ana e gjykatës dhe pastaj të regjistruar në zyrën përkatëse komunale të kadastrit, e cila do ta informojë Agjencinë Kadastrale të Kosovës (AKK). Shpenzimet e rregullimit të fletëposedimit mbulohet nga Kompania e Projektit.
- Persona të tjerë që pohojnë pronësi por që kanë mungesë të fletëposedimit të plotë ligjor duhet të dëshmojnë se kanë jetuar dhe punuar këtë tokë gjatë 10 viteve të fundit apo që e kanë trashëguar apo ligjërisht i kanë përvetësuar të drejtat e uzufruktit në tokë. Kërkesa e tyre do të shqyrtohet nga zyra për zhvendosje e Kompanisë së Projektit dhe duhet të mbështetet me dëshmi nga komuna (për shembull, regjistra tatimorë), institucionet qeveritare (për shembull, regjistra të shkollës) apo dëshmi nën betim të fqinjëve.
- Nëse ka pretendime të pazgjidhura ndaj pronës, duke përfshirë konteste ndaj pronësisë, kufijve administrativë apo trashëgimisë, Kompania e Projektit deponon vlerën e vlerësuar të tokës dhe pronës në një llogari të veçantë dhe do ta paguan kompensimin apo do t’i ofrojë përfitimet tjera të zhvendosjes vetëm pasi që konteksti të jetë gjykuar në gjykata. Nëse ka hipotekë në pronë, Kompania e Projektit negocion me penglënësin me synim të transferimit të hipotekës në një pronë të re të blerë nga pronari i prekur i tokës.
- AKP-ja është përgjegjëse për të përcaktuar pronësinë e tokës së braktisur dhe/apo të zënë nga të tjerë gjatë luftës të vitit 1999. Pasi që AKP-ja të ketë përcaktuar

pronësinë e tokës, pronari do të kualifikohet për përfitimet e njëjta të zhvendosjes sikurse pronarët tjerë të prekur të tokës. Personat që nuk janë pronarë e që kanë zënë pronën që u përket personave që janë larguar gjatë luftës kanë të drejtë në kompensim në para të gatshme për ndërtimet anekse dhe pagesa për humbje të të korrurave aktuale, por nuk kanë të drejtë në asnjë përfitim tjetër shtesë të zhvendosjes.

Toka e rehabilituar. Ekziston një mungesë akute e tokës së mirë bujqësore në këtë zonë përreth kompleksit të propozuar të mihjeve dhe të energjisë. Opsioni i ofrimit të një parcele të tokës së rehabilituar mëton të inkurajojë Kompaninë e Projektit që të rehabilitojë dhe shfrytëzojë një zonë të madhe të deponive të djerrinave që aktualisht janë në pronësi të KEK-ut. Për ta bërë këtë opsion më atraktiv, Kompania e Projektit do t'u ofrojë pronarëve të tokës një zonë më të madhe të tokës sesa parcela e prekur dhe/apo një pako të përfitimeve shtesë, të cilat mund të përfshijnë asistencë teknike dhe/apo përdorim të përbashkët të pajisjeve.

Parcelat alternative. Kompensimi i destinuar për blerjen e tokave alternative inkurajon ekonomitë e prekura familjare që të blejnë parcela të reja të tokës bujqësore. Shuma e vënë në dispozicion për blerje të tillë do të përcaktohet në bazë të zëvendësimit të vlerës së tokës së prekur, shtëpisë apo asete të tjera të patundshme, plus 10% pagesë stimuluese që ka për qëllim ta bëjë këtë opsion më atraktiv për pronarët e prekur të tokës. Pasi që të jetë përcaktuar shumta, pronari i tokës është i lirë që të tentojë të gjejë një parcelë të përafërsisht të njëjtës vlerë Kompania e Projektit shqyrton blerjen e propozuar, për të siguruar se toka dhe mjetet tjera janë vlerësuar saktë dhe se dokumentacioni është në rregull dhe se nuk ka konteste të pazgjidhura për kufijtë administrativë, dhe paguan tokën, duke transferuar fletëposedimin drejtpërsëdrejti te pronari i prekur i tokës.

Kompensimi. Kompensimi me para të gatshme nuk është opsioni i preferueshëm për pronarët e tokës që kanë tokë bujqësore tërësisht të prekur. Përvoja ka treguar se familjet e prekura shpeshherë e shfrytëzojnë kompensimin e tyre për qëllime tjera, duke i lënë ata pa mënyra të rikthimit të mjeteve të jetesës dhe standardit të tyre të mëhershëm të jetesës. Veç kësaj, tregjet e tokës në zonën e projektit nuk janë zhvilluar sa duhet dhe është vështirë që të përcaktohen vlera aktuale e tregut për tokë bujqësore. Kompensimi me para të gatshme është opsioni i vetëm real për pronarët e tokave, pronat e të cilëve janë prekur pjesërisht. Gjithashtu, ka situata kur kompensimi mund të jetë mundësi e mirë për ekonomitë e prekura familjare për ta ndryshuar gjendjen e tyre. Kompania e Projektit angazhon një ekip të vogël të ekspertësh, të cilët shpjegojnë opsione të ndryshme të ekonomive të prekura familjare dhe i ndihmojnë ata që të vendosin se cili opsion është më i përshtatshmi. Ekspertët e rishikojnë gjendjen e të gjithë pronarëve të tokave të prekura dhe diskutojnë përdorimin e kompensimit me ta para se të jetë bërë kompensimi.

Bujqit qiramarrës dhe të tjerët që punojnë në tokë (gjysmatarët, njerëzit me të drejta të shfrytëzimit). Bujqit qiramarrës pranojnë kompensim të barabartë me dy vite të humbjes së fitimeve neto dhe shpenzimet e transportit dhe tarifave ligjore. Ky kompensim ka për qëllim t'u ofrojë qiramarrësve dhe gjysmatarëve kohë të mjaftueshme për të rregulluar një qiramarrje të re apo marrëveshje të re të ndarjes së punës së tokave dhe supozon se ata do të humbin së paku një

vit të të korrurave dhe se do të ju duhet një vit shtesë për gjetjen e një pronari të tokës që i lejon ata të marrin apo ndajnë në punë një parcelë ekuivalente të tokës bujqësore.

Personat e prekur nga humbja e vendbanimit

Pronarët. Personave shtëpitë e të cilëve janë prekur nga zhvendosja do t'u ofrohet një shtëpi alternative në një fshat të ri apo kompensim në para të gatshme. Këto opsione do të ofrohen për të gjithë bujqit që banojnë në fermat e tyre dhe për të gjitha ekonomitë familjare që kanë në pronësi apo shfrytëzojnë shtëpi në zonën e prekur nga projekti, pavarësisht statusit të tyre ligjor të fletëposedimeve të tyre. Megjithatë, ai nuk aplikohet për qiramarrësit që kanë marrëveshje formale të qiramarrjes apo për personat e tjerë që kanë zënë shtëpi që janë braktisur nga njerëzit që janë larguar gjatë luftës.

Shtëpia zëvendësuese përfshinë ofrimin e strehimit bazik që përmbush standardet nacionale dhe komunale. Madhësia e saktë e shtëpisë zëvendësuese dhe numri i dhomave përcaktohet nga madhësia e ekonomisë familjare dhe jo nga vlera e shtëpisë së prekur. Ky opsion ka për qëllim që ta bëjë zhvendosjen më atraktive për më të varfrit, familjet më të cenueshme, veçanërisht personat që jetojnë në kushte nën standarde të strehimit. Po ashtu, ai është menduar të jetë opsion që i lejon fqinjët, miqtë dhe të afërmit që të vazhdojnë të jetojnë në afërsi. Pronarët të cilën zgjedhin për të pranuar shtëpi me hapësirë më të vogël sesa shtëpitë e tyre ekzistuese po ashtu do të pranojnë kompensim me para të gatshme të llogaritur për të mbuluar diferencën. Nëse dëshirojnë, personave me shtëpi më të mëdha, më të vlefshme, do t'u mundësohet që të zgjedhin kompensim në para të gatshme për shtëpitë e tyre dhe strukturat tjera dhe parcelë ndërtimi në fshatin e zhvendosjes.

Projekti i ri i vendbanimit ofron shtëpi me qasje në të gjitha shërbimet bazike të infrastrukturës, duke përfshirë qasje në rrugë, drenazhimin, ujësjellësin, kanalizimin, energjinë elektrike dhe ndriçimin.

Personave që kanë marrë shtëpi të reja në fshatin e zhvendosjes do t'u lëshohen fletëposedime të me të drejta të plota, të lëshuara në emrat e të dy bashkëshortëve. Personave që nuk janë pronarë dhe personave shtëpitë fillestare të të cilëve kishin vlerë më të vogël sesa vlera nominale e shtëpisë së re nuk t'u lejohet shitja apo bartja e shtëpisë së tyre te një palë e tretë për një periudhë prej së paku pesë viteve pa miratimin e menaxherit të programit të zhvendosjes. Kjo bëhet për të ulur mundësinë e të hyrave të ulëta për familjet që i shesin shtëpitë e tyre për para të gatshme.

Qiramarrësit. Qiramarrësve që marrin shtëpitë apo banesat e tyre me qira me kontratë të rregullt të qiramarrjes do t'u paguhet një shumë e barabartë me gjashtë muaj qira plus të gjitha shpenzimet kalimtare për transportimin e mjeteve personale dhe çfarëdo tarife ligjore apo takse, si dhe do t'u ofrohet asistencë për gjetjen e një akomodimi të përshtatshëm alternativ.

Personat e prekur nga humbja e veprimtarisë afariste apo lokaleve komerciale

Synimi i kësaj është të nxiten biznesmenët meshkuj e femra që atë veprimtari ta vazhdojnë gjetiu apo të nisin një biznes të ri. Nëse biznesi i prekur kryhet në ndërtesë në pronësi të pronarit, pronarit do t'i ofrohet opsioni i lokacionit alternativ për biznes në fshatin e zhvendosur apo kompensim për tokën dhe lokalet e tij/saj në vlerë të zhvendosjes. Po ashtu, pronarit do t'i paguhet në barasvlerë gjashtë muaj të humbjes së fitimeve neto nëse ai/ajo zgjedh kompensimin

dhe dymbëdhjetë muaj të humbjes së fitimeve neto nëse ai/ajo zgjedh nisjen e një biznesi të ri apo hapjen e biznesit në fshatin e zhvendosur apo gjetiu në komunë. Gjithashtu, Kompania e Projektit do t'i paguan të gjitha shpenzimet kalimtare, si paketimi dhe transportimi i pajisjeve dhe/apo stoqeve për lokacionin e ri, tarifatat ligjore, taksat dhe kështu me radhë, si dhe/apo do të ofrojë asistencë dhe mbështetje logjistike për nisjen e një biznesi të ri.

Nëse biznesi operon në lokale të huazuara apo të marra me qira, pronari të biznesit do t'i paguhen gjashtë muaj të humbjes së fitimeve neto apo dymbëdhjetë muaj të fitimeve neto nëse ai/ajo zgjedh nisjen e një biznesi të ri apo fillon një biznes të ri në lokacionin e zhvendosjes apo në një lokacion tjetër në të njëjtën komunë. Po ashtu, pronari do të paguhet për të gjitha shpenzimet kalimtare, duke përfshirë paketimin dhe transportimin e pajisjeve dhe stoqeve, pagesave ligjore, taksave, e të tjera, dhe/apo do të ofrojë asistencë dhe mbështetje logjistike për nisjen e një biznesi të ri.

Personat e prekur nga humbja e punësimit

Personave që humbin punësimin e tyre si rrjedhojë e përvetësimit apo mbylljes së vendeve të tyre të punës do t'u ofrohet shuma e barasvlershme me së paku gjashtë muaj rrogë (bazuar në fitimet mesatare gjatë vitit para mbylljes së biznesit të punëdhënësit). Do të bëhet një pagesë e njëhershme prej 1,000 Euro për të ndihmuar me trajnime për ngritjen e aftësive apo për shpenzime të kërkimit të vendeve të punës për personat me punësim me orar të plotë dhe në punësim të rregullt me gjysmë orari. Projekti do të paguan çdo pagesë të ndërprerjes së vendit të punës në pajtim me ligjin, duke përfshirë pagesat e përcaktuara nga kohëzgjatja e shërbimit dhe/apo faktorë të tjerë.

Shpenzimet kalimtare

“Shpenzimet kalimtare” janë shpenzimet e ndërlidhura me zhvendosjen nga lokacioni fillestar në një lokacion tjetër si dhe humbjet e fitimeve dhe/apo benefiteve të jetesës. Ato përfshijnë të gjitha shpenzimet ligjore, pagesat për anketime dhe regjistrime për bartjen e pronësisë dhe blerjen e pronës së re, si dhe shpenzimet e paketimit dhe transportimit të mjeteve personale të ekonomisë së prekur familjare, pajisjeve dhe bagëtisë. Gjithashtu, do të mbulohet çdo dëmtim i mjeteve dhe mallrave personale gjatë zhvendosjes.

Në raste kur vendosja në lokacionin të ri hasë në vonesa, atëherë Kompania e Projektit është e detyruar ti bartë të gjitha shpenzimet për qira dhe shpenzimet e jetesës.

Personat e cenueshëm

Studimi bazik socio-ekonomik për çdo PVZH duhet t'i identifikojë ekonomitë e cenueshme familjare, siç janë nënat prindër të vetëm, vejat dhe vetë, personat me aftësi të kufizuara, apo personat që jetojnë në varfëri të skajshme. Kompania e projektit gjatë zhvendosjes i vlerëson këto ekonomi familjare në kontest të rrjeteve ekzistuese formale dhe joformale të sigurisë dhe alokon resurse në PVZH për t'i ndihmuar ata me sigurimin e strehimit dhe shërbimeve adekuate për ta.

Kriteret për kualifikim

Datat e ndërprerjes

Data e regjistrimit dhe incizimit definitiv të popullsisë dhe ekonomive familjare të kryer për përgatitje të PVZH shfrytëzohet si datë e ndërprerjes për kualifikim për përfitime të zhvendosjes. Pasi të jetë kryer regjistrimi definitiv i ekonomive të prekura familjare për një zonë të caktuar që do të zhvendoset, asnjë person i ri që hyn në zonën në fjalë nuk do të ketë të drejtë në kompensim. Procedura e rishikimit do të hartohet për të përcaktuar situatën e njerëzve të cilët pretendojnë se nuk janë përfshirë në regjistrim. Informatat e regjistrimit do të ndahen me Qeverinë dhe Autoritetet Komunale dhe ato bashkërisht do të jenë përgjegjëse për të siguruar se zona e prekur nuk pushtohet nga banorët e paligjshëm që kërkojnë përfitime të zhvendosjes.

Ekonomia familjare

Termi “ekonomi familjare” nënkupton secilën familje apo bashkësi tjetër e personave, të cilët deklarojnë se ata jetojnë së bashku dhe së bashku i shpërndajnë të ardhurat e veta për plotësimin e nevojave themelore jetësore.

Realizueshmëria e zonave të mbetura në implementimin e Projektit Energjia nga Linjiti

Aktualisht KEK-u e definojnë pronën si pjesërisht të prekur nëse zona e mbetur është më shumë se 14 *ari* – apo 0.14 hektarë (një *ari* është 10m x 10m). Megjithatë, në praktikë, disa prona klasifikohen si pjesërisht të prekura. Një definicion më praktik që mund të miratohet është ofrimi i palëve të prekura me opsionin e kompensimit së tërë pronës së tyre, nëse:

- është prekur cilado pjesë e strukturës së shtëpisë, fermës apo biznesit;
- duhet të shpronësohet më shumë se 25% e pronës totale;
- zona e mbetur është më pak se 0.5 hektarë;
- prona lihet pa qasje të realizueshme apo humb qasjen në asetet kritike, siç janë furnizimi me ujë apo rrymë; apo
- nëse pronari mund të dëshmojë se prona e mbetur nuk është më e realizueshme për përdorimin që kishte pasur më herët. Në këtë rast, pronari duhet të dëshmojë se zona e mbetur më nuk është e realizueshme.

Në cilindo nga këto raste, pronari origjinal do të ketë të drejtë të mbajë zonën e mbetur nëse ai/ajo e dëshiron një gjë të tillë.

Përcaktimi i vlerës së aseteve

Parimet e përcaktimit të vlerës

Toka dhe të gjitha asetet tjera të prekura kompensohen në pajtim me kriteret e parapara sipas kësaj KPZh-je. Kjo nënkupton se të gjitha ndërtesat, anekset, rrethojat dhe strukturat tjera, pemët, të mbjellurat e përhershme dhe shtojcat, duke përfshirë kullosat dhe të mbjellat aktuale, do të vlerësohen sipas shpenzimit të duhur për zëvendësimin e tyre, pavarësisht gjendjes së tyre në kohën e përcaktimit të vlerës. Përcaktimi i vlerës së pemëve të frutave dhe të mbjellave të përhershme do të marrë parasysh vlerën e të korrurave që të humb. Vlera e tokave bujqësore duhet të vlerësohet në bazë të klasifikimit të llojit të tokës që aktualisht aplikohet nga KEK-u, por çmimi do të bazohet në çmimet e paguara në transaksionet aktuale të tokës në të njëjtën komunë dhe komunat fqinje. Është me rëndësi të sigurohet se përcaktimi i vlerës bazohet në transaksione të vërteta të tokës. Veç kësaj, pronarët e tokave, shtëpive dhe bizneseve do të marrin kompensim për të gjitha shpenzimet kalimtare.

Procedurat speciale për Projektin Energjia nga Linjiti

Kompania e Projektit është përgjegjëse për zbatimin e procedurave, të cilat do të përkufizohen më në hollësi në PVZH.

Së paku, Kompania e Projektit fillon me kontaktimin e palëve të prekura. Në fazat fillestare kjo përfshin përcjelljen e kontakteve tanimë të krijuara nga MMPH/Projekti Hade dhe KEK-u, mirëpo nevojitet një regjistrim i ri, definitiv. Çdo fazë vijuese e projektit të mihjes kërkon një regjistrim të ri që do të kryhet si pjesë e përgatitjeve për çdo PVZH. Nëse pajtohen palët e prekura, Kompania e Projektit do të ndërmerë një studim të detajuar të zonës dhe pronës së peronit të prekur dhe do të vlerësojë: i) nëse prona duhet të kategorizohet si plotësisht apo pjesërisht e prekur, dhe ii) vlerën e tërë tokës dhe aseteve në zonën apo pronën e prekur, varësisht nëse ajo kategorizohet si pjesërisht apo plotësisht e prekur.

Përcaktimi fillestar i vlerës do të specifikohet, duke ndjekur procedurat e KEK-ut, duke dalluar vlerën e pandarë të tokës dhe vlerën e çdo aseti që preket: shtëpi, ahuri, rrethojat, pemët dhe të korrurat e përhershme, të korrurat aktuale, e të tjera. Ky vlerësim i hollësishëm do t'i tregohet palës së prekur, Qeverisë dhe Komunës përkatëse. Nëse ekonomia e prekur familjare pranon vlerësimin, Kompania e Projektit kërkon aprovimin e PVZh.

Nëse pala e prekur nuk pranon vlerësimin apo nëse ajo beson se disa asete nuk janë përfshirë apo janë nënvlerësuar, dhe si rrjedhojë nuk mund të arrihet marrëveshja për përcaktimin e vlerës përmes kësaj Kornize të Politikës së Zhvendosjes, pala e prekur mund ta parashtojë ankesë në Komisionin e Pavarur për shqyrtim të ankesave. Në rast se pala e pakënaqur nuk pajtohet me vendim të Komisionit, atëherë vlerësimi për atë pronë të paluajtshme nuk do të jetë subjekt i zhvendosjes sipas kësaj kornize dhe do të fillojë procedura e shpronësimit në përputhje me procedurat dhe afatet e parapara ligjore sipas ligjit për shpronësim të pronës së paluajtshme.

Kompania e Projektit është përgjegjëse për të gjitha shpenzimet e ndërlidhura me realizimin e Planit të Zhvendosjes, duke përfshirë shpenzimet e studimeve, përcaktimit të vlerës, kërkimeve të regjistrimit të tokës, përgatitjen dhe ofrimin e zhvendosjes në hapësirën për zhvendosje, e të tjera.

Kompania e Projektit do të jetë e detyruar të bëjë kompensime në rast të ndonjë vonese të arsyeshme dhe vonesat e tilla do të specifikohen në PVZh.

Konsultimi Publik

Procedurat speciale për Projektin Energjia nga Linjiti për konsultime publike

Tanimë janë kryer një varg konsultimesh publike si pjesë e përgatitjes së VSMS-së. Kompania e Projektit, do të kryejë konsultime publike në zonën e prekur. Objektivi i konsultimeve të mëtutjeshme publike është shpjegimi i parimeve të KPZH-së dhe zhvillimi i PVZH-së.

Një nga synimet e konsultimeve duhet të jetë krijimi i kanaleve efektive të komunikimit ndërmjet familjeve të prekura, autoriteteve lokale dhe qendrore dhe Kompanisë së Projektit. Kjo mund të përfshijë:

- Një apo më shumë komisione negociuese të përbërë nga përfaqësues të fshatrave të prekur nga çdo fazë e projektit të mihjes dhe energjisë, të cilët do të ndihmonin në zhvillimin e hollësive të planit të zhvendosjes, monitorimit të zbatimit të tij, zgjidhjes së kontesteve në lidhje me të drejtat e kualifikimit për përfitime dhe kompensim, si dhe ndoshta negociimi për masat e kompensimit për infrastrukturë lokale (për shembull xhami, kisha apo varreza). Anëtarët e komisionit do të përzgjidhen nga ana e të gjithë të rriturve që jetojnë në fshatrat e prekura.

Detajet e kriterëve, opsionet dhe procedurat e planit të zhvendosjes duhet të bëhen publike. PVZH-ja do të jetë e hapur për një apo më shumë konsultime publike në afat prej 30 ditësh. Një gjë e tillë përfshin shtypjen e libërthave, radio-programet dhe ndoshta televizionin.

Plani kohor dhe buxheti

Plani i integruar kohor dhe buxheti

Tabela e hollësishme kohore për realizimin e programit të zhvendosjes do të zhvillohet si pjesë e çdo PVZH-je. Ajo do të zhvillohet në bashkëpunim të ngushtë me planifikuesit e projektit, duke marrë parasysh kohën e fazave të ndryshme të përfundimit.

Orari kohor dhe buxheti përafërt

Orari kohor dhe buxheti përafërt për Projektin Energjia nga Linjiti është në zhvillim e sipër në bashkëpunim të ngushtë me planifikuesit e minierës, duke marrë parasysh kohën e propozuar për fazat e ndryshme të zgjerimit të fushës së Sibovcit. Çështja më kritike në këtë fazë është përgatitja e PVZH-së për fazën e minierës së Sibovcit.

Shtojca A: Modeli i Planit të Veprimit për Zhvendosje

1. Hyrje

- Emri dhe adresa e subjektit kërkues
- Lokacioni i projektit (me harta të hollësishme)
- Përshkrimi dhe historia e projektit dhe punëve të ndërlidhura
- Analiza e alternativave për çdo komponentë (minierat, transporti, qasja në rrugë/hekurudha, termocentral, deponi të hirit apo pellgje të hirit), duke treguar se alternativat janë zgjedhur për të minimizuar zhvendosjen, por pa rrezikuar sigurinë publike;
- Institucionet e përfshira në projekt (zonat e përgjegjësisë);
- Pjesëmarrja e agjencive lokale, organizatave të personave të prekur;
- Statusi aktual i projektit; dhe
- Çështjet e mbetura.

2. Studime dhe definicione të bazës socio-ekonomike

- Zonat e prekura në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë nga projekti dhe punët e shoqëruara duke përfshirë zonat e sigurisë ndërmjet punëve dhe popullatës më të afërt.
- Informatat e sakta të personave të prekur sipas kategorisë: humbja e tokës dhe strehimit (pronarët/qiramarrësit), humbja e strehimit (pronarët/qiramarrësit), humbja e tokës (pronarët/qiramarrësit, gjysmatarët, të tjerët), humbjet tjera në të ardhura (shitoret me pakicë, ndërmarrjet e vogla, etj), grupet tjera të prekura. Kjo duhet të përmbliidhet në tabela
- Definicionet kryesore: datat e ndalimit; realizueshmëria e zonave pjesërisht të prekura; definicioni i ekonomive familjare¹; kriteret e shfrytëzuara për lloje të ndryshme të përfitimeve të zhvendosjes
- Identifikimi i çdo grupi të cenueshëm (personat e zhvendosur brenda vendit apo refugjatët, grupet etnike, punëtorët e patokë, kryefamiljaret femra, etj.);

¹ Ekonomi familjare – secila familje apo bashkësi tjetër e personave, të cilët deklarojnë se ata jetojnë së bashku dhe së bashku i shpërndajnë të ardhurat e veta për plotësimin e nevojave themelore jetësore.

- Zotërimi i tokës i popullatës së prekur (pronarët privatë, toka në pronësi publike, tokat komunale apo të fshatit, toka e përbashkët, qiramarrësit, gjysmakë, etj. – të identifikohen të gjitha çështjet që mund të prekin të drejtat në tokë apo strehim, për shembull transaksionet apo trashëgimia e parregullt, tatimet e papaguara, pronat që janë braktisur gjatë luftës – përfshijnë konsiderata të të drejtave të kryefamiljareve femra dhe femrave që jetojnë në martesë zakonore);
- Prodhimet bujqësore, bagëtia, të ardhurat tjera bujqësore;
- Asetet e përbashkëta produktive që mund të preken (kullotat komunale, pyjet e përdorura për dru zjarri, lumenjtë dhe liqenet e përdorura për peshkim, etj.);
- Aktivitetet tjera ekonomike – çdo punësim lokal që mund të preket;
- Nivelet e vlerësuara të të ardhurave të ekonomive familjare dhe shpenzimet (përfshirë shpenzimet mesatare për shërbime themelore: ujë, kanale të ujërave të zeza, rrymë dhe tatime lokale);
- Infrastruktura sociale dhe e transportit (shkollat, qendrat shëndetësore, xhamia, kishat, varrezat, rrugët për qasje, urat, etj).

3. Korniza ligjore dhe institucionale

- Baza ligjore, fushëveprimi dhe procedurat për përvetësimin e tokës
- Përgjegjësia e sponsorëve të projektit
- Roli i qeverisë dhe autoriteteve lokale në përgatitjen dhe realizimin e planit të zhvendosjes
- Përgjegjësia për pagesën e kompensimit dhe zhvendosjes
- Vlerësimi/kompensimi i tokës dhe pronës
- Mekanizmat për zgjidhjen e kontesteve dhe problemeve mbi fletëposedimet e tokës apo shtëpisë
- Aprovimi nga autoriteti shpronësues dhe procedurat e aprovimit
- Komunikimi dhe koordinimi me autoritetet lokale, OJQ-të dhe organizatat e personave të prekur
- Procedurat për shqyrtimin e ankesave.
- Përgjegjësia për monitorim dhe vlerësim.

4. Kompensimi dhe rehabilitimi

- Kriteret për të pasur të drejtë në kompensim (“datat e ndalimit”, titullarët joformalë dhe ilegalë, qiramarrësit afatgjatë dhe zotëruesit e tjerë)
- Opsionet e kompensimit për humbje të tokës (humbja totale, humbja e pronave të shfrytëzueshme, humbja e pjeshme, kufizimet në përdorim, siç janë skajet e rezervuarëve, linjat e transmisionit)
- Opsionet e kompensimit për humbje të pronës (pronarët, qiramarrësit, zotëruesit, të tjerët)
- Përshkrimi i detajuar i zgjidhjes së propozuar tokë për tokë dhe me para të gatshme, përfshirë zgjedhjet dhe faktorët që mund të prekin zgjedhjet dhe problemet potenciale siç janë borxhet, hipotekat apo tatimet e papaguara të tokës
- Përshkrimi i detajuar i zgjidhjeve të strehimeve të propozuara dhe të shërbimit, me një analizë të zgjidhjeve të preferuara dhe problemeve potenciale (shpenzimet e ofrimit të shërbimit, mirëmbajtjes, tatimeve, stilit të strehimit)
- Procedurat, metodologjia dhe përgjegjësia për përcaktimin e vlerës së tokës dhe pronës, procedurat për pagimin e kompensimit dhe koha e kompensimit
- Zgjidhja e kontesteve
- Kompensimi i humbjes së përkohshme të të ardhurave dhe mjeteve të jetesës nga të korrurat, shitoret me pakicë dhe bizneset tjera (përcaktimi i vlerës, kompensimi, koha, zgjidhja e kontesteve)
- Procedurat, përgjegjësia për vlerësim të humbjes së të ardhurave, kompensimi, koha dhe zgjidhja e kontesteve.
- Programet për trajnime dhe zhvillim institucional
- Kompensimi për humbjen e infrastrukturës sociale dhe/apo transportit dhe mjeteve të trashëgimisë sociale dhe/apo kulturore (xhamitë, kishat, varrezat, memorialët e luftës, etj.)
- Ndikimi i familjeve të prekura në popullatën “mikpritëse”, dhe masat për të shmangur konfliktet e mundshme
- Lehtësimet për akomodimin e kërkesës së fluksit të punëtorëve ndërtimorë (shërbimet shëndetësore, shkollimi, etj)

5. Transporti dhe çështjet tjera kalimtare

- Aranzhimet për të zhvendosur ekonomitë e prekura familjare në lokacionet e reja (transporti, akomodimi i përkohshëm, transporti i mobileve, pajisjet, bagëtitë, etj)
- Koha e zhvendosjes, veçanërisht në lidhje me ciklin bujqësor dhe vitin shkollor

6. Zbutja mjedisore

Kjo i referohet ndikimeve mjedisore të programit të zhvendosjes dhe jo ndikimeve të projektit që shkakton zhvendosjen, dhe përfshin:

- Ndikimet në programin e strehimit, përfshirë ndikimet e shoqëruara me ndërtimin dhe ndikimet afatgjate, posaçërisht në burimet dhe përdorimin e ujit, kanalizim, drenazh të rrugëve, deponimin e mbeturinave të ngurta
- Ndikimi i mundshëm i popullatës së zhvendosur në shërbimet lokale (shëndetësi, shkollim)
- Ndikimi i popullatës së zhvendosur në popullatën lokale (veçanërisht grupet e cënueshme)
- Ndikimet në resurset natyrore, siç janë grumbullimi i druve të zjarrit, peshkimi, etj
- Ndikimi i projekteve për rikthimin e të ardhurave: programet bujqësore dhe të bagëtisë (shpyllëzimi, potenciali për erozion të tokës, përdorimi i kemikaleve bujqësore); industrinë e vogla (përdorimi i ujit, potenciali për kontaminim)
- Menaxhimi mjedisor dhe plani i edukimit për programe të zhvendosjes
- Të gjitha planet për ofrimin e strehimit, shërbimeve infrastrukturore apo sociale të popullatës mikpritëse të prekur nga fshatrat e zhvendosura

7. Konsultimet publike dhe procedurat e ankimimit

- Konsultimet, shpalojsja publike dhe procedurat sociale të komunikimit
- Përgjegjësia institucionale për konsultime dhe komunikim
- Përshkrimi i konsultimeve të kryera për të përgatitur planin e zhvendosjes dhe orarin për aktivitete të ardhshme
- Palët e përfshira në konsultime publike

- Masat për të siguruar se janë konsultuar grupet e cënueshme tërësisht
- Rishikimi, përmbledhja dhe shpalosja e rezultateve të konsultimeve dhe mënyra se si ato integrohen në planifikimin e zhvendosjes
- Mekanizmat e propozuar për regjistrimin dhe zgjidhjen e ankesave

8. Orari dhe përgjegjësitë për zbatimin e planit të zhvendosjes

- Plani kohor i studimeve bazë dhe regjistrimit të përgjithshëm, vlerësimit të tokës/pronës/të korrurave/humbjes në fitime, pagesës së kompensimit, zhvendosjes, rehabilitimit, rindërtimit të infrastrukturës sociale, etj (kjo duhet të përgatitet si diagram gantt dhe duhet të jetë i lidhur me kohën e punëve civile dhe aktiviteteve shoqëruese
- Skica që tregon përgjegjësitë institucionale për çdo komponent të planit të zhvendosjes, shtegu kritik dhe plani kohor.

9. Shpenzimet

- Shpenzimet e përafërta për çdo komponentë dhe nënkomponentë të planit të zhvendosjes (shpronësimi i tokës dhe kompensimi, strehimi, infrastruktura sociale, rehabilitimi ekonomik, trajnimi)
- Shpenzimet e përafërta për çdo komponentë, të ndara sipas muajit/vitit të pritur të pagimit
- Shpenzimet e përafërta për çdo komponentë dhe nënkomponentë, të ndara sipas institucionit përgjegjës dhe muajit/vitit të pritur
- Shpenzimet e rrjedhshme, sipas institucionit dhe sipas muajit/vitit (shpenzimet e stafit, zyrës dhe shpenzimet rrjedhëse, transporti)
- Analiza e shpenzimeve të kompensimit dhe zhvendosjes si proporcioni i shpenzimeve të përgjithshme të projektit.

10. Monitorimi dhe vlerësimi (M&V)

- Përgjegjësitë për M&V;
- Procedurat e raportimit;

- Indikatorët për M&V (strehimi/shërbimet, indikatorët ekonomikë, shëndetësorë, shkollorë);
- Opsioni i “Panelit të ekspertëve”, për rishikimin e çështjeve specifike; dhe
- Vlerësimi ex-post